



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
PROGRAMI I FONDIT TË EKSELENCËS

Komunikatë për Shtyp

Ju bëjmë me dije se, për të katërtin vit radhazi, nëpërmjet Fondit të Ekselencës dhënë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qeveria Shqiptare po kontribuon me një fond prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë lekë) në vit, për mbështetjen financiare për studentët shqiptarë të shkëlqyer, të cilët janë pranuar të kryejnë studimet e ciklit të parë, të dytë dhe studimet e doktoratës jashtë vendit në universitetet më të mira të botës si dhe për nëpunësit civilë të administratës shtetërore.

Shqipëria me anë të këtij programi siguron mbështetjen e studentëve të shkëlqyer, të cilët janë pranuar në njërin prej universiteteve më të mira të botës sipas renditjes së Times Higher Education “Renditja Botërore e Universiteteve” për vitin më të fundit.

Po kështu në kuadrin e reformimit të administratës publike dhe ngritjes së kapaciteteve të kësaj administrate, nga ky fond do të përfitojnë dhe punonjës të administratës shtetërore, të cilët do të kryejnë studime “Master” në një prej universiteteve më të mira, sipas renditjes së mësipërme, për të ndjekur në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve një program “Master” me kohëzgjatje 1 vjeçare në fushat e mëposhtme:

- Politika publike
- Administrim publik
- Politika ekonomike
- Politika arsimore
- Politika shëndetësore
- Urbanistikë dhe zhvillim urban
- Menaxhim i financave publike
- E drejtë administrative/publike
- Studime Evropiane

Studentët që do të kryejnë studimet “Bachelor” dhe “Master” duhet të jenë pranuar në një nga 15 universitetet më të mira.

Studentët që do të kryejnë studimet e doktoratës duhet të jenë pranuar në njërin prej 15 universiteteve më të mira të botës në shkencat shoqërore dhe ekonomike, apo në njërin prej 50 universiteteve më të mira të botës në shkencat natyrore dhe teknike, sipas renditjes së fundit, të përgjithshme dhe/ose asaj specifike sipas fushave, të “Times Higher Education”- Renditja botërore e universiteteve, ose të jenë pranuar në njërin prej universiteteve të mirënjohura ndërkombëtare për studime në albanologji.

Për studentët e shkëlqyer që do të ndjekin studimet “Bachelor” dhe “Master”, si dhe për nëpunësit e administratës shtetërore që do të kryejnë jashtë vendit studimet “Master”,

mbështetja financiare nga Fondi i Ekselencës mund të jetë i pjesshëm apo i plotë dhe masa e bursës do të variojë nga një universitet në tjetrin sipas parashikimit të shpenzimeve që do të kryejë çdo universitet.

Për studentët e doktoratës mbështetja financiare do të mbulojë vetëm shpenzimet e jetesës.

Studentët dhe doktorantët, që do të përfitojnë bursë nga Fondi i Ekselencës dhe që do të formohen në universitetet më të mira të botës kanë si detyrim që pas përfundimit të studimeve të japin kontributin e tyre për tre vjet në Shqipëri, ndërsa punonjësit e administratës publike për 4 vjet në administratën shtetërore.